



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS



**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Nr. \_\_\_\_\_  
Malishevë, me 10.10.2018

**Projekti komunal për ndihmë fermerëve me “Makina spërkatëse (të krahut)”**

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të Bujqësisë: Perimtarisë, Pemëtarisë, Vreshtarisë, Lavërtarisë, etj, Komuna e Malisheves respektivisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural, publikon këtë:

**SHPALLJE**

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ndihmës me mekanizëm bujqësor: **(me spërkatëse krah)** sektorët e Pemëtarisë dhe Vreshtarisë, si dhe sektorëve tjerë. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në këtë projekt do të kontribuoj me:

- Financim me 100 % të kostos së Paisjes Bujqësore **(SPËRKATËSE KRAHU)**.
- Fermeri është i liruar nga bashkëfinancimi.
- Këshillime profesionale dhe monitorim të vazhdueshëm të fermerëve përmes ekspertëve të drejtorisë.

**Kriteret e konkurrimit:**

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Malishevës
2. Të merret me kultivimin e pemëve, perimeve, me vreshtari, etj.
3. Të jetë i gatshëm për bashkëpunim të ngushtë me Komunën, konkretisht DBPZHR-ën.
4. Përparësi kanë fermerët, të cilët nuk kanë përfituar nga projektet e Drejtorisë së Bujqësisë.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Kërkesa e shkruar nga vetë fermeri dhe numri kontaktues i telefonit
2. Vërtetimi i tatimit në pronë
3. Letërnjoftimi kopje
4. Lista poseduese

**Afati i aplikimit nga data 10.10.2018 deri me 26.10.2018**

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

\_\_\_\_\_  
Murat Hoxha Dr. Mr. Vet.